REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2018:029961
Datë: 17.09.2019
Numri i dokumentit: 00514841

P.nr.641 /17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka, sekretarja juridike Suzane Rudi, në çështjen penale kundër të pandehurve 1. N.H dhe 2. SH.H, të akuzuar për shkak të veprës penale "Vjedhje e rëndë" nga neni 327 par 1 nën paragrafi 1.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës me numër PP/II.nr.2186-4/16 të datës 13.10.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik më datë 12.09.2019, në praninë e Prokurorit të Shtetit Paulin Pashku dhe të pandehurve, më datë 13.09.2019 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 17.09.2019 përpiloi këtë:

A K T GJ Y K I M

I pandehuri N.H nga ....., i lindur më datë ...., nga i ati S...dhe e ëma R...., e gjinisë Sh...., me numër personal,...., i martuar, prind i 2 fëmijëve, ka të kryer shkollën mesme, punon në pylltari, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i gjykuar edhe më parë, mbrohet në liri.

I pandehuri SH.H nga ...., i lindur më datë ....., nga i ati S...dhe e ëma R.... e gjinisë Sh...., i martuar, prind i një fëmije, ka të kryer shkollën fillore, punon me fasada, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i gjykuar edhe më parë, mbrohet në liri.

JANË FAJTOR

Sepse gjatë vitit 2016 në ...., të pandehurit me forcë kanë hapur derën e shtëpisë duke e dëmtuar atë dhe kanë depërtuar në brendi të shtëpisë së të dëmtuarit R.L, në atë mënyrë që kishin marrë një TV Plazma, e markës "Konak", tre shpues elektrike (burmashina), një makinë për qepje, një jakne e lëkurës dhe një rrip ngjyrë të bardhë në vlerë prej 200€

Me të cilin veprim në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në baze të neneve 2, 17, 41, 45, 46, 73, 74, 75, 76 të KPRK-së, 359, 360, 361 dhe 365 të KPRK-së të pandehurit i:

GJYKON

1. Të pandehurit N.H **i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntë dhjetë ditëve),** i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi dhe

Dënim me gjobë në shumë prej 200 € (Dy qind euro) të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në dy rata në afat prej 2 muajsh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur nga 20 € (njëzet euro) për çdo ditë burg.

2.Të pandehurit SH.H **i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntë dhjetë ditëve),** i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi dhe

Dënim me gjobë në shumë prej 200 € (Dy qind euro) të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në dy rata në afat prej 2 muajsh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur nga 20 € (njëzet euro) për çdo ditë burg.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohen të pandehurit që në emër të shpenzimeve procedurale dhe në emër të paushallit gjyqësorë në mënyrë solidare t'i paguajnë kësaj gjykate shumën prej 20.00 € dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit secili të paguaj shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën kundër 1. N.H dhe 2. SH.H, të akuzuar për shkak të veprës penale "Vjedhje e rëndë" nga neni 327 par 1 nën paragrafi 1.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës me numër PP/II.nr.2186-4/16 të datës 13.10.2017, duke propozuar gjykatës që të pandehurit të shpallen fajtor dhe t'u shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 12.09.2019, në këtë shqyrtim të pandehurit e pranuan fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës

2018:029962

Prokurori i Shtetit duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurve, duke i propozuar gjykatës që të pandehurit ti shpall fajtorë dhe t'u shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që të pandehuri kanë pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:
- Të pandehurit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;
- akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se të pandehurit kanë pranuar fajësinë i cili është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje Vjedhje e rëndë nga neni 327 par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në mënyra, vende dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73,74,75, 76 të KPRK-së, dhe gjeti

Për të pndehurin N.H, si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, gjendjen e tij familjare – i martuar dhe prind i dy fëmijëve dhe moshwn e re tw tw pandehurit, ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti, përpos veprimeve që plotësojnë figurën e veprës penale.

Për të pndehurin SH.H, si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, gjendjen e tij familjare – i martuar dhe prind i një fëmije, dhe moshwn e re tw tw pandehurit, ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti, përpos veprimeve që plotësojnë figurën e veprës penale.

Sipas bindjes së Gjykatës dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurve, duke i marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve.

Dënimin me burgim gjykata e shqiptoi duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe minimumin dhe maksimumin e dënimit dhe dënimin nën minimumin e paraparë (minimumi i paraparë për këtë vepër penale është 3 vite) gjykata ua shqiptoi të pandehurve duke marrë parasysh faktin se në kohën e kryerjës së veprës penale të pandehurit ishin të rinjë, ndërsa në momentin e shqiptimit të dënimit ishin penduar për veprën penale të kryer, si dhe që nga ajo kohë ka ndryshuar edhe rrethanat familjare, ku të dy të pandehurit janë martuar dhe janë kryefamiljar dhe prind, ndërsa dënimin me gjobë gjykata e shqiptoi duke u bazuar në

2018:029962

mundësitë ekonomike të pagesës së kryerësve. Gjykata ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil është marrë në bazë të nenit 458 par.2 të KPPK-së.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës u detyruan të pandehurit që në emër të shpenzimeve procedurale dhe në emër të paushallit gjyqësor t'i paguajnë kësaj gjykate shumën prej 20.00 €,

Konform nenit 39 par 3 pika 3.1 të ligjit Ligji Nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit gjykata e obligoi të pandehurit që secili veç e veç të paguajnë shumën prej 30.00 € Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit dhe atë në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
Dega në Kaçanik
P.nr. 641/17 datë 17.09.2019

Sekretarja juridike,
Suzane Rudi

Gjyqtari
Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

2018:029962